



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2020:129351

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05627097

P.nr.78/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtaren e vetme gjykuese Sabrije Rraci, në çështjen penale ndaj të akuzuarit H. D nga K, rr. „ M.Sh’’ për shkak të veprës penale, Ushtrim I kundërligjshëm I veprimtarisë mjeksore se farmaceutike nga neni 256 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamentit i Përgjithshëm PP/II.nr.925/2020 të datës 05.10.2020, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, me datë 05.10.2022, në praninë e prokurorit të shtetit, Ramiz Buzhala, dhe të akuzuarit H. D dhe përfaqësuesit të autorizuar av. Lon Palushaj, si dhe deklaratat e dëshmitareve: B. G, L.K, B.A, A. Xh dhe dëshmitari H. N, mori dhe publikisht shpalli me dt. 27.03.2024 në prezencën e palëve, ndërsa me datë 26.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

H. D, i biri i D dhe nëna Gj, e gjinisë S, i lindur me dt. ... në Fsh.. Z K. P, ndërsa tani me banim në Klinë Rr. „, N. T nr. me numër personal, të dhëna këto të vërtetuar nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e lartë të mjeksisë dega sanitare, specializimi për mbikëqyrje sanitare, I martuar baba I dy fëmijëve, pensioner , realizon pension të të pleqërisë, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Qe nga data e gjerë me datë rreth orës në barnatoren e tij në emër „T . P’’ në rr. „F.E’’ në Klinikë, pa autorizim ligjor kryen shërbime farmaceutike për të cilat me ligjin nr. 04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale kërkohet kualifikim I posaqëm, në atë mënyrë që, pasi që të pandehurit I skadon licenca e veprimtarisë së barnatores „T. P’’ dhe atë me datë i njëjti vazhdon të ofrojë për shitje produkte medicinale gjersa me datë zyrtarët policor së bashku me zyrtarët e ATK-së, hasin në të pandehurin i cili kishte hapur barnatorën dhe zhvillonte veprimtarinë e tij.

-me këtë ka kryer veprën penale „Ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike’’ nga neni 256 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4; 7; 17; 20; 21; 41; 42; 43; 46; 69 dhe 256 par 1 të KPRK-së dhe neneve 359, 365 dhe 366 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

I.Të pandehurit H. D, i shqiptohet DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Dënimi me kusht do t’i revokohet nëse i pandehuri kryen vepër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, konform nenit 50 të KPRK-së.

III.Obligohet i dënuari qe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 euro ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

III. Dënimi plotësues: Konform nenit 63 par. 1 të KPRK_së, të pandehurit i shqiptohet dënimi plotësues „Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës’’ në afat prej një (1) viti.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.925/2020 të datës 05.10.2020, ka akuzuar H. D, për shkak të veprës penale, „Ushtrim i kundërligjshëm I veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike” nga neni 256 par.1 të KPRK-së.

Gjykata konstaton se kjo lëndë është kthyer në rigjykim, kjo gjykatë duke u bazuar në vërejtjet e Gjykatës së Apelit, u mundua që t’iu përmbahet maksimalisht. Pasi që i akuzuari nuk e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, gjykata vazhdoi me paraqitjen e radhës së provave në shqyrtimin gjyqësor, me fjalën hyrëse të palëve.

Gjykata caktoi mbajti shqyrtimin gjyqësor kryesor me dt. 27.03.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij av. Lon Palushaj.

Pasi dëshmitarët e propozuar nga prokurorja Lumturije Hoxha, në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt. 31.05.2022, e këta janë dëshmitarët e aprovuar nga gjykata: B. A, A. Xh të cilët janë inspektor farmaceutik pranë Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe dëshmitarët B. G, H. N dhe L. K, të gjithë punëtor të ATK-së në Pejë. të cilët kanë dhënë dëshmi me dt. 27.07.2022.

Gjykata në fillim të shqyrtimit gjyqësor, pasi i kishte ftuar dëshmitarët, e të cilit kan munguar, gjykata i pyet të gjitha palët prezentë, mbrojtësin e të pandehurit av. H. D, të pandehurin dhe prokurorin Ramiz Buzhala. Të gjitha palët prezente veq e veq u deklaruan që deklaratat e dëshmitareve, të lexohen dhe të konsiderohen të lexuara. Pasi nuk ka pas propozime tjera nga palët prezentë.

Me këtë gjykata ka marrë aktvendim, pasi të gjitha palët u dakorduan që dëshmitë e dëshmitareve të konsiderohen të lexuara, për shkak që kjo çështje penale të mos zvarritet.

Ashtu që gjykata kalo në fjalën hyrëse, ku prokurori i shtetit është deklaruar se qëndron pranë fjalës hyrëse të dhënë nga prokurori paraprak me dt. 31.05.2022, i cili ka deklaruar se përpos provave materiale do të administrohen edhe edhe provat personale, si dhe do të dëgjohet i pandehuri, besoj se do të dëshmoj se aktakuza është e bazuar dhe e mbështetur me prova. Mbrojtësi i të pandehurit av. Lon Palushaj ka deklaruar se pasi që kjo çështje penale është kthyer në rigjykim, për arësyet e cekura në sencëat e kaluara, si dhe në fjalën përfundimtare të datës 05.10.2022, i propozoi gjykatës që këtë aktakuzë ta hudhë poshtë, për arësye të dhëna si

në procesverbal. Po ashtu konsideroi se duke u bazuar edhe në aktvendimin e gjykatës së Apeli PAL.nr.1627/21 të dt. 20.04.2023, ankesa jonë si mbrojtës është e aprovuar dhe gjykata e Apelit ka konstatuar qe qështja të kthehet në rigjykim.Ngase të pandehurit nuk i është shpallur dënimi plotësues në muaj të plot.

I pandehuri e përkrah fjalën hyrëse të mbrojtësit të tij.

Gjykata pasi konstatoi leximin e deklaratave të dëshmitareve me pëlqimin e palëve, pas marrjes së aktvendimit i lexon dëshmitë e dëshmitareve një nga një, të cilët dëshmitar i ka propozuar prokuroria në seancë të shqyrtimit gjyqësor.

1.Dëshmitari B. G, inspektor i ATK-së,në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me dt. 07.04.2020 kemi dale në Klinë, për shkak të disa ankesave të qytetarve.Në momentin e vizitës barnatorja ka qenë e hapur, barn aka pasur pak, pork an qenë në rafte dhe i pandehuri ka pas antill të bardhë. Në bazë të asaj qa kemi pare nuk ka lëshuar kupona, dhe ne siq e dime ky është ndëshkuar nga ATK-ja.Ne kemi qenë së bashku me polici, I njëjti deklaroi se nuk është e thënë qe qdoherë të ketë klienta, lokali ka qenë i hapur. Ashtu qe qdo mos lëshim I kuponave është shkelje dhe sanksionohet në bazë të ligjit,

2. Dëshmitari B. A në seancën e shqyrtimit gjyqësor deklaroi se une e kam nënshkruar procesverbalin, dhe mbes në tërsi pran tij. Fillimisht kemi kërkuar dokumentet e nevojshme për të pasur një biznes të hapur. Këtu I pandehuri na ka ofru licencë me afat të skaduar. Në këtë rast të gjitha produktet dhe pajisjet i konfiskohen. Ne kemi shku në control pasi kemi pas një ftesë zyrtare nga policia , nën dyshimin se subjekti në fjalë operon me produkte medicinale pa licencë. Pra nëse pala nuk bënë kërkesë për riaplikim Brenda 7 ditëve atëherë barnatorja konsiderohet ilegale. I njëjti deklaroi se pal aka deklaruar se ka shit here pas here shërbime farmaceutike. Pra pala vet e ka nënshkru procesverbalin ditën e inspektimit.Aty kemi has në produkte farmaceutike të cilat kan qenë me afat por edhe me afat të skaduar. Vetë pal aka deklaroi se ka shitë here pas here barna.

3. Dëshmitari A. Xh, në seancën e shqyrtimit gjyqësor deklaroi, se mbes pranë procesverbalit të cilin e kam nënshkruari njëjti gjatë inspektimit të barnatores së tij, është hasur e hapur pa licencë të biznesit dhe pa licencë peronale të barnatores.Ne në bazë të ligjit 04-L-190 për produkte dhe paisje medicinale, kurse me udhëzim administrative 11-2015 operohet me pakic në barnatore. Kjo merret si subject illegal kur nuk ka licencë se licencimi bëhet për 5 vite, kur kalon ky afat llogaritet i pa licencuar. Gjatë inspektimit ne kemi operu sipas kërkesës së policies së krimeve ekonomike, se barnatorja në fjalë, ka operu pa licencë. Dhe kemi gjetur se

afati 5 vjeçar i ka skaduar barnatores në fjalë i ka skaduar, dhe nuk është bërë ricilësim conform ligjit. A. Xh, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kadeklaruar se, deklaroi, se më kujtohet rasti, dhe me kërkesë të qytetarve për shtrenjtimin e barnave, kemi dal së bashku me policinë dhe aty ka qenë i pandehuri, i cili nuk ka pas arkën të fikur, dokumentacion nuk ka pasur, dhe na ka thënë se nuk jam duke punuar por kam dal pasi është paraqit kërkesa për barna dhe kam dal për ti shitur ato barna qe i ka pasur. Ne ia kemi kërku lecencën, dhe kemi pare se afati ka qenë I skaduar me dt. 17.11.2019, dhe nuk ka pas furnizime pas kësaj date, nuk kemi pas dëshmi për këtë. Ashtu qe ne sipas ligjit 03-222 neni 13 par. 1 për mos mbajtje të librave dhe par 6 për mos lëshim të kuponave , kemi dërgu rastin të zgjona (departamenti qe bënë shqiptimin dhe ekzekutimin e gjibave) . I pandehuri ka qenë me mantil të bardhë. Arka fiskale nuk ka qenë.

5. Dëshmitari L. K në seancën e shqyrtimit gjyqësor deklaroi se me kërkesë të qytetarve, në qendrën informative në Prishtinë, kemi dal në terren së bashku me policinë, ku ka qenë i pandehuri, kur ne i kemi vizitu, arkën e ka pas të fikur, dokumentacion nuk ka pas, i cili n aka thënë se nuk jam duke punuar, pork am dal pasi është paraqit kërkesa për barna, dhe kam dal për ti shitur ato barna qe i kam pas. Pikë së pari ja kemi kërkuar licencën, e kemi pare se afati ka qenë i skaduar me dt. 17.11.2019 dhe nuk ka pas furnizime pas kësaj dite. Andaj ne e kemi dergu rastin në Zgjona (Departamenti qe bën shqiptimin dhe ekzekutimin e gjobave).

6. Dëshmitari H. N në seancën e shqyrtimit gjyqësor deklaroi, se po e di për rastin, kemi pasur disa shqetësime verbale të qytetarve, lidhur mbi ngritjen e qmimeve në kohën e pandemisë, jo vetëm të barnatoreve por edhe të artikujve ushqimor. Konform kësaj drejtori I administrates ka dhënë urdhër qe ti vizitojmë tatimpaguesit dhe te konstatohet gjendja. Ndër të tjera këtu është vizituar edhe barnatorja në Klinë, H. D BI 810817398, me shoqërim nga Policia e Kosovës. Gjatë vizitës inspektorët kanë konstatuar se barnatorja ishte e hapur dhe Brenda është gjetë personi qe ishte pronar H. D, arka fiskale është gjetur e pa aktivizuar në zero, qka nënkupton se atë ditë nuk ka lëshuar kupon fiscal dhe nuk ka bërë regjistrim në libra fiscal.

I akuzuari H. D, në mbrojtjen e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se ditën kritike kanë ardhur dy persona pa uniformë dhe janë paraqit si njësit hetimor i policies, dhe të njëjtit më thane se duhet të bastisim, dhe ka pas polic edhe rreth objektit, une i kam kërku vendim nga prokurori nëse kan të drejt për bastisje, nuk kan prezantuar dhe kan përdor dhunë, kanë bërë bastisje pa prezencën time. Une kam qenë inspector sanitar për 5 vite, sa e di une policia e

ka rolin e asistetit. Më vonë ka ardhë inspektori sanitar, i cili ka konstatu se nuk kam qenë duke punuar. Une jam pronar i lokalit. Une në momentin kur më ka skadu licenca e kam paraqit në administratën tatimore qe e kam ndërpre veprimtarinë dhe e kam qit biznesin në zero, dhe kam paraqit dëshmi. Une nuk kam punuar 4 muaj, nuk ka pasur klient, aty në lokal kam qenë vetëm për pastrim.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor i administroi edhe provat materiale dhe personale siq janë: raporti zyrtar, njësi i hetimeve nr. i rastit DE-144 dt. 07.04.2020, Raporti I oficerit L A, dt. 07.04.2020, raporti I policit M. M dt. 07.04.2020, shënimi zyrtar nga NRHKEK-Pejë dt. 07.04.2020, procesverbali mbi intervistimin e të dyshuarit dt. 07.04.2020, foto nga licenca nr. L5/2014/12/01071 lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale, Foto nga Certifikata e Regjistrimit 810317398 në emër të H. H, Procesverbali mbi inspektimin e kryer nga Inspektorati farmaceutik me nr. rendor 01115 dt. 07.04.2020 si dhe shkresat tjera të lëndës.

Po ashtu gjykata, pas shqyrtimit të deklaratave e dëshmitareve si dhe pas administrimit të provave materiale gjatë shqyrtimit gjyqësor, dëgjimit të mbrojtjes së të akuzuarit dhe pas vlerësimit me ndërgjegje të secilës provë një nga një dhe në lidhje reciproke me njëra tjetrën, konform nenit 361 të KPPRK-së, vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 27.03.2024, qendroi në tërsi pranë fjalës përfundimtare të dhënë me dt. 05.10.2022 i cili ka deklaruar se pas administrimit të provave ne këtë shqyrtim gjyqësor, konsideroj se përtej dyshimit te bazuar është vertuatr se i pandehurit H. D, e ka kryer veprën qe i vihet ne barre. Këtë e themi sepse pas administrimit te provave e duke përfushi procesverbale nga inspektorët farmaceutik dhe tatimor, është kostauta se i pandehuri ditën kritike e ka pasur te hapur barnatoren me mundësi te ofrimit te shërbimeve farmaceutikë, dhe pse disa muaj me pare i kishte skaduar licenca pra afro 4 muaj me pare. Nëse analizojmë përgjigjet e dhëna nga dëshmitari B. A qe ditën kritike ka qenë ne vendngjarje dhe me detyrën e inspektorit farmaceutik i njejti ka deklaruar se ditën kritike te këtu i pandehuri kane hasur se i nejtji operon pa licencën e biznesit dhe veprimtarisë si qarkullues me pakicë për produkte medicinale. Fjalët se pas kërkimi te licienec nga inspektori i pandehuri ka ofruar licence me afat te skaduar. Po ashtu inspektori ka sqaruar se nje biznes qe shet produkte dhe pajisje medicionle pa licencë të njëjit i konfiskohen, po ashtu ky dëshmitar ka sqaruar se ligji qe e rregullon veprimtarinë e inspektorve farmaceutik i

autorizon për insoektim ad hoc dhe te pa planifikuar 24 ore ne dite. Kështu qe nuk kërkohet autorizim i veqnete për te kryer kete inspektim. Po ashtu ky dëshmitar ka deklaruar se gjate inspektim këtu i pandehuri ka deklaruar disa here se ka shit here pas here barna, pra ka ofru shërbime farmaceutike. Poashtu ngjashëm kane deklaruar edhe inspektoret tjetër dhe dëshmitarët e dëgjuar ne shqyrtim gjyqësor. Edhe vete i pandehuri ne polici dhe prokurori e ka punuar se ditën kritike apo qe nga date 17.12..2019 e deri ne ditën kkritike 07.04.2022 nuk ka pasur licencë valide për veprimtarinë farmaceutike, ku vete i pandehuri e ka arsyetur se nuk ka mundur ta siguroj vazhdimin e licencës. Po ashtu dëshmitaret kanë treguar se ditën kritike barnatorja e te pandehuri ka qene e hapur dhe po ashtu këtu i pandehuri ka pas te veshur mantil te bardhe, qka është edhe nje prove rrethanore se i nejtei e ka kryer vepren penale qe i vihet ne barre. Kërkoj nga gjykata qe mbrojtjes se te pandehurit te mos ja fale besimin se e nejta eshë e orientuar ne drejtim të ikjes apo zvogëlimit te përgjegjësie penale, dhe nje mbrojtje e tille nuk ka mbështetje ne asnjë prove tjetere te administruar. Kërkoje nga gjykata qe te njëjti ta shpall fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit, po ashtu kërkoj qe krahas dënimit kryesor ti shqiptoj edhe dënimin plotësues te propozuar si ne aktakuzë.

Mbrojtësi i te pandehurit Av. Lon Palushaj në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 27.03.2024 ka deklaruar se qëndron në tërsi pranë fjalës përfundimtare të dt. 05.10.2022,i cili poashtu gjatë vendosjes i propozoi gjykatës qe ti ketë parasysh vërejtjet e Apelit, ku në faqen e dytë është konstatuar se ankesa është e bazuar në provat materiale qe janë siguruar në këtë qështje penale, ku gjatë bastisjes nuk ka pasur urdher për bastisje nga prokuroria si dhe nuk ka pasur urdher retroaktiv, për aprovim të bastisjes. Njëkohësisht këtu kemi te bjen me nje qeshtje penale dhe jo administrative, andaj duke u bazuar në dispozitat e KPRK-së, së mëhershme e qe kan përmbajtje të njëjtë me nenin 107, 108, 109 të KPRK-së është i obliguar urdhëri retroaktiv, për aprovim të bastisjes, qe provat konsiderohen të pa praneshme.

KPRK-se fazat hetimore i udhëheq prokuroria policia te monitoruar me vendim te gjyqtares se proc paraprake. Diten kritike te bastisjes nuk ka marr pjese dy dëshmitare siq ee parasheh neni 108 i KPPRK-se n, nuk ka pas as aktvendim për bastisjes dhe as urdhër te shkruar, duke u bazuar ne këto fjalën jon kontestuese dhe nenit 111 te KPPKRse te gjitha provave e sigurae pa vendimin gjyqtarit te proc paraprake ligji e parasheh te konsiderohet te papranueshme. Po ashtu është shume me rendësi se te gjithë dëshmitaret e dëgjuar ne seances e date 27.07.2022 e me konkretisht dëshmitari L K ne faqen 12 te procesverbali, ne pyetjen e prokuroi se ka qene dera e lokalit, dëshmitari është përgjigjet se dera ka qene e mbyllur dhe nuk ka pasur blerëse. Po

ashtu dëshmitari i mëhershëm ka theksuar se ne jemi organ administrativ dhe kur gjejmë shkelje kemi te drejte te shqiptojme gjoba qe ne rastin tone ska shqiptuar. Duke u bazuar ne këtë qe kemi nje gjobe mandatorë dhe nuk i përmbush kushtet e veprës penale duke u bazu nenin 4 te KPPRK-se për te nejjten qeshtjen i njejtj subjekti nuk mund te dënohet dy her. Po ashtu prokuroria gjatë kësaj procedure penale dhe fazës hetimore ka dështuar te siguroj palet e dëmtuara te cilat kane qene ne ditën kritike, e duke u bazuar ne nenin 20 te 3 KPRK-se, nuk ka veprën penale pa shkak dhe pasoje. Pasojat qe mund te konsiderohen janë administrative dhe te cilat i ka pranuar borgjet dhe i përmbush obligimet e kjo mund te konsiderohet me se pagu nje kundërvajtje, Po ashtu dëshmitari i sotëm nga ATK ishte i qarte ne përgjigjet e veta ne pytjen e parashtruar nga prokurori se lokali ne ditën kritike ju ka shqiptuar nje gjobë. I nejjti u thirr edhe ne raporte tje i lexoj e te cilët kane deklaruar se nuk kanë gjetur parregullsi qe hynë ne kuadër te veprës penale.

Ndërsa ne deklaratë thirret qe e ka nënshkruar kinse H. D, se kam punu kohe pas kohe ku i pandehuri ka deklaruar se un nuk e kam lexu dhe nuk është pjese e imja edhe pse e kam nënshkruar, edhe në prokurori është deklarata se nuk ka ofru shërbime po edhe po të ekzistonte, prape duke u bazu ne nenin 123 par.5 te KPPRK-së që thotë deklarata e te pandehurit nuk mund te shërbejë si prove e vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin te pandehurit. Duke u bazuar se ne shkresa te lëndës mungojnë provavat qenësore, duke u baze ne te gjitha këto prova asnjë prove e vetme nuk është vërtetuar se i njëjti e përmbush figurën e veprës penale.

I pandehuri ne fjalën përfundimtare deklaron: E përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësit te tij.

Nga provat e administruara e të cilave gjykata ua fali besimin pa dyshim u vërtetua se i akuzuari H. D, ka kryer veprën penale, „ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 256 par 1 të KPRK-së, ashtu që i pandehuri ditën kritike me dt.

17.12.2019 e gjerë me datë 07.04.2020 rreth orës 12:30 në barnatoen e tij në emër „T P” në rr. „F. E” në K, pa autorizim ligjor kryen shërbime farmaceutike për të cilat me ligjin nr. 04/L-190 për produkte dhe paisje medicinale kërkohet kualifikim i posaqëm, në atë mënyrë që, pasi që të pandehurit I skadon licenca e veprimtarisë së barnatorës „T. P” dhe atë me datë 07.12.2019 I njëjti vazhdon të ofrojë për shitje produkte medicinale gjersa me datë 07.04.20120 zyrtarët policer së bashku me zyrtarët e ATK-së, hasin në të pandehurin i cili kishte hapur barnatorën dhe zhvillonte veprimtarinë e tij.

Nuk është kontestuese se i akuzuari H. D është pronar dhe shitës i barnatores, kjo u vërtetua nga deklaratat e pothuajse të gjithë dëshmitareve të dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor si dhe nga mbrojtja e të akuzuarit i cili e ka pohuar se ka punuar kohë pas kohe në barnatoren e tij, kur është has nga inspektorët sanitar. Me licencë të skaduar dhe arka fiskale nuk ka qenë e lëshuar.

Provat të cilave gjykata ua ka falur besimin:

Fakt i pakontestueshëm është se ditën kritike i pandehuri ka qenë në barnatoren e tij, me mantil të bardhë, dhe është vërtetuar se ka punuar me licencë të skaduar, dhe arka fiskale nuk ka qenë e lëshuar, pra pa lëshuar kuona fiscal, kjo u vërtetua nga deklaratat e të gjithë dëshmitareve të dhëna në shqyrtimin gjyqësor si dhe nga provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Po ashtu i pakontestueshëm është fakti se i akuzuari është pronar i ati lokali dhe, i cili edhe vet e ka pranuar se ka shit barrëra kohë pas, kohe. Po ashtu edhe vete i pandehuri ne polici dhe prokurori e ka punuar se ditën kritike apo qe nga date 17.12..2019 e deri ne ditën kritike 07.04.2022 nuk ka pasur licencë valide për veprimtarinë farmaceutike, ku vete i pandehuri e ka arsyetur se nuk ka mundur ta siguroj vazhdimin e licencës

Nga Informacionet e personit mbi të kaluarën të siguruara nga Policia e Kosovës rezulton se ndaj të akuzuarit nuk ka asnjë rast tjetër penal.

Nga deponimi i dëshmisë së dëshmitari B. A, i cili kishte qenë ditën kritike në vendngjarje dhe me detyrën e inspektorit farmaceutik i njejt i ka deklaruar se këtu i pandehuri ka hasur se i nejtji operon pa licencën e biznesit dhe veprimtarisë si qarkullues me pakicë për produkte medicinale. Fjalët se pas kërkimi te licienec nga inspektiori i pandehuri ka ofruar licence me afat te skaduar. Po ashtu inspektori ka sqaruar se nje biznes qe shet produkte dhe pajisje medicionle pa licencë të njëjti i konfiskohen, po ashtu ky dëshmitar ka sqaruar se ligji qe e rregullon veprimtarinë e inspektorve farmaceutik i autorizon për insoektim ad hoc dhe te pa planifikuar 24 ore ne dite. Kështu qe nuk kërkohet autorizim i veqnate për te kryer kete inspektim.

Nga deponimi i dëshmisë së dëshmitarit, B. G gjykata vërtetoi faktin se i akuzuari ka deklaruar se ne kemi dal në teren për shkak të disa ankesave të qytetarve, une kam dale me L. K dhe H. N dhe në momentin e vizitës barnatorja ka qenë e hapur.Mirëpo ne nuk kemi gjet paisje

fiskale, ashtu që sipas përvojës tone, qdo moslshim i kuponave është shkelje dhe sanksionohet në bazë të ligjit.

Edhe dëshmitari B. A ka deklaruar se me të dal në tëren për kontroll, ne kemi vizituar të akuzuarin. Ashtu që gjatë inspektimit ka ofruar licencë me afat të skaduar, ashtu që licenca me afat të skaduar konsiderohet si mos me pas licenc fare.

Dëshmitari A. Xh ka deklaruar edhe ky njëjt sikurse edhe dëshmitarët tjerë, se farmacisti i cili nuk e vazhdon licencën, pasi licencimi bëhet për 5 vite, atëhere kur kalon ky afat ai llogaritet i pa licencuar edhe Dëshmitari L. K, ka deklaruar pothuajse njëjt si dhe dëshmitarët tjerë.

Gjykata i ka vlerësuar dhe analizuar mirë, të gjitha dëshmit e dëshmitarve, dhe të gjitha dëshmitë kanë qenë pothuajse të njëjta, dhe plotësisht ua ka falur besimin, pasi që ato deklarata ishin në lidhmëri njëra me tjetrën dhe në harmoni edhe me shkresat tjera të lëndës.

Gjykata i ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se duhet t'i falet besimi i plotë provave të propozuara nga prokuroria e shtetit, të cilët në tërësi e vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, pasi që të gjitha provat e prezantuara në shqyrtim kanë lidhshmëri logjike, kohore, dhe janë bindëse dhe të qarta dhe janë në harmoni të plotë si me dëshmitë e dëshmitareve ashtu edhe me provat e tjera materiale.

Gjykata i ka falur besimin e plotë deklaratave të dëshmitarëve, për faktin se dëshmitë e tyre janë kuptimplote dhe se të njëjtit kanë deklaruar në mënyrë të njëjtë në të gjitha fazat e procedurës penale, dhe se një gjë e tillë argumentohet edhe nga provat tjera që janë proceduar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, siç janë dhe provat materiale dhe të njëjtat deklarata gjykata i ka vlerësuar si deklarata mjaft të rëndësishme, për shkak se të njëjtit i kanë përshkruar në mënyrë të qartë dhe me përpikmëri të gjitha rrethanat se si është kryer kjo veprë penale ditën kritike dhe veprimet të cilat i ka ndërmarrë i akuzuari.

Gjykata vlerësoi edhe mbrojtjen e të akuzuarit H. D të dhënë në shqyrtim gjyqësor në të cilën e ka mohuar në tërësi veprën penale, si dhe në fjalën përfundimtare i cili e mohon të ketë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë mirëpo të njëjtit nuk ia fali besimin pasi që e njëjta deklaratë ngeli si e vetme dhe në kundërshtim me të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor. Po ashtu ky kundërshtim nga i akuzuari nuk është i bazuar në prova dhe fakte, është në kundërshtim me të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe ka për qëllim të shmangët përgjegjësisë penale.

Poashtu gjykata vlerësoi mbrojtjen e të autorizuarit të pandehurit mirëpo nuk mundi që t'ia fali besimin pasi mbrojtja e tij ishte në kundërshtim me të gjitha provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor kryesor.

Pretendimit i mbrojtësit av. Lon Palushaj: se provat janë marrë në mënyrë të kundërligjshme, nuk qëndrojnë, për shkak se , veprimet e inspektoriatit rrjedhin nga autorizimet ligjore dhe në këtë rast nuk nevojitet aprovimi paraprak e as aprovimi retroaktiv nga gjykata , konkludim të cilin e ka mbështetur edhe gjykata e Apelit në aktvendimin me PN.nr. 19/2022 të dt. 05.04.2022 në faqen 2 paragrafi 1 që gjendet në shkresat e lëndës.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave të rëndësishme bazuar në faktet dhe provat e lartshënuara konstatoi gjendjen si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm dhe gjeti se në veprimet e të akuzuarit janë konsumuar elementet esenciale të veprës penale të lartcekur, „Ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike” nga neni 256 par.1 të KPRK-së, pasi që më parë gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të tij, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor të precizuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata, rikujton se sipas nenit 21 të KPRK-së, dashja është element subjektiv i veprës penale e cila mund të nxjerrët nga rrethanat faktike të rastit. E nga rrethanat e rastit konkret dhe provat e administruara kemi arritur në përfundim se i akuzuari i lartcekur, veprën penale „Ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike” nga neni 256 par.1 të KPRK-së, e ka kryer me dashje të drejtpërdrejtë apo dashje direkte.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese për të mori parasysh se i njëjti për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, moshën e shtyrë i cili i ka 73 vjet, gjendjen e dobët ekonomike, është pensionist dhe mbajtës i vetëm i familjes, ndërsa rrethana rënduese mori parasysh dashjen kryerjen e veprës penale.

Andaj të akuzuarit i shqiptoi dënimin me kusht si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 dhe 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi për shumën e të hollave në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave është marrë konform nenit 39 par.3, nënpar.3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 par.1 të KPPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA KLINË /DEPARTAMENTI I
PËRGJITHSHËM

P.nr.78/2023, datë 26.04.2024

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Sabrije Rraci

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.